



Bazuar në nenin 36, paragrafi 1, nënparagrafi 1.17, dhe nenin 65, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës; nenin 85, paragrafi 1, dhe nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare; si dhe nenin 85, paragrafi 2, dhe nenin 86, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit, Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 janar 2019, miratoi këtë:

UDHËZIM

PËR FORMULARIN E INFORMATAVE MBI KREDITË KONSUMUESE

Neni 1

Qëllimi dhe Fushëveprimi

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është të përcaktojë Formularin e Informatave mbi Kreditë Konsumuese (më tutje: Formulari) dhe mënyrën e shpalosjes së tij, në zbatim të Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit.
2. Ky udhëzim aplikohet për të gjitha institucionet financiare të licencuara/regjistruara nga BQK-ja për të ushtruar aktivitet të kredidhënies sipas ligjit në fuqi.

Neni 2

Përkufizimet e Termave

1. Për qëllime të këtij Udhëzimi, shprehjet e përdorura kanë kuptimin si më poshtë:
 - 1.1. *Konsumator* – çdo person fizik i cili blen dhe përdor mallra ose shërbime për plotësimin e nevojave të veta, që nuk ka të bëjë me veprimtari tregtare, biznesore, zeytare apo profesionale;
 - 1.2. *Kredidhënës* – çdo institucion financiar që ushtron aktivitet të kredidhënies sipas ligjeve në fuqi;
 - 1.3. *Institucioni financiar* – çdo institucion që është i licencuar/regjistruar nga BQK-ja në bazë të Ligjit për Bankën Qendrore ose ndonjë ligji tjetër relevant;
 - 1.4. *Ndërmjetësues* – çdo palë e tretë, person fizik ose juridik, i angazhuar në promovimin, ofrimin, ose shitjen e produkteve apo shërbimeve financiare të ofruara nga një institucion financiar, si dhe i angazhuar në përgatitjen, konkludimin dhe administrimin e marrëveshjeve dhe të drejtave kontraktuale në lidhje me ato produkte apo shërbime.

Neni 3

Përmbajtja e Formularit

1. Institucioni financiar gjatë prezantimit të produktit kreditor dhe para hyrjes në ndonjë marrëveshje për kredi konsumuese, duhet t'i sigurojë konsumatorit informatat e duhura për të krahasuar ofertat e ndryshme në mënyrë që ai të marrë një vendim për lidhjen e marrëveshjes.
2. Informatat e tilla do të shpalosen nga kredidhënësi me anë të Formularit, i cili i është bashkëngjitur këtij udhëzimi në Shtojcën 1. Të gjitha informatat e aplikueshme në Formular duhet të plotësohen.
3. Konsumatori dhe kredidhënësi duhet të vendosin datën dhe nënshkrimin në Formular dhe të dyja palët duhet të mbajnë nga një kopje të nënshkruar.
4. Kur jepet në formë elektronike, Formulari mund të nënshkruhet në mënyrë elektronike ose kredidhënësi dhe konsumatori mund ta nënshkruajnë një dokument që konfirmon se Formulari i është dhënë konsumatorit.

Neni 4

Informacioni për Garantuesin

1. Në rastet kur për lëshimin e kredisë konsumuese kërkohet garantuesi, institucionet financiare duhet që t'i ofrojnë garantuesit Fletën e Informatave për Garantuesin, që i është bashkëngjitur këtij Udhëzimi në Shtojcën 2. Fleta e Informatave për Garantuesin duhet të nënshkruhet nga garantuesi.
2. Po ashtu institucionet financiare duhet që në raste të tilla t'i ofrojnë garantuesit një kopje të Formularit, të nënshkruar nga konsumatori dhe kredidhënësi.

Neni 5

Detyrimi për Sqarime

1. Institucionet financiare duhet të japin sqarime për informacionin e shpalosur deri në masën e nevojshme për një konsumator ashtu që i njëjti të kuptojë informacionin dhe të jetë në gjendje të marrë një vendim në lidhje me ofertën.
2. Institucionet financiare duhet të japin shpjegime shtesë kur kërkohet nga konsumatorët.

Neni 6

Ruajtja e Formularit

1. Institucionet financiare duhet të mbajnë dhe ruajnë kopjet e nënshkruara të Formularit së paku 1 (një) vit në rastet kur marrëdhënia kontraktuale nuk arrihet, kurse në rastet kur marrëdhënia kontraktuale arrihet Formulari duhet t'i bashkëngjitet dosjes së kredisë dhe duhet të ruhet për aq sa ruhet i gjithë dokumentacioni tjetër i kredisë.
2. Formulari duhet t'i paraqitet BQK-së kurdo që kërkohet.

Neni 7

Zbatimi, Masat Përmirësuese dhe Dënimet Civile

Institucionet financiare të cilat shkelin këtë udhëzim do të jenë subjekt i masave përmirësuese dhe ndëshkimore të parashikuara me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Neni 8

Dispozitat Kalimtare

Institucionet financiare duhet t'i plotësojnë kërkesat e këtij Udhëzimi brenda një (1) muaji nga data e hyrjes së tij në fuqi.

Neni 9

Shtojcat e këtij Udhëzimi

Shtojca të këtij Udhëzimi janë Shtojca 1- Formulari i Informatave mbi Kreditë Konsumuese dhe Shtojca 2 – Fleta e Informatave për Garantuesin.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi më 1 shkurt 2019.

Fehmi Mehmeti
Kryesues i Bordit Ekzekutiv

SHTOJCA 1

FORMULARI I INFORMATAVE MBI KREDITË KONSUMUESE

1. Emri dhe detajet e kontaktit të kredidhënësit

Kredidhënësi	<i>[Emri i kredidhënësit]</i>
Adresa	<i>[Adresa e kredidhënësit për t'u përdorur nga konsumatori]</i>
Numri i Telefonit (*)	
Adresa e postës elektronike (*)	
Numri i faksit (*)	
Adresa e web-it	
(*) Ky informacion është opsional për kredidhënësit	

2. Përshkrimi i karakteristikave kryesore të produktit të kredisë

Lloji i kredisë	
Vlera totale e kredisë dhe valuta <i>(Nënkupton kufirin maksimal ose shumën totale të disponueshme, të kredisë)</i>	
Kushtet që rregullojnë tërheqjen e fondeve <i>(Nënkupton si dhe kur do merren paratë)</i>	
Kohëzgjatja e kontratës së kredisë	
Këstet dhe, kur është e mundur, mënyra se si do të shlyhen këstet.	<i>Konsumatori duhet të paguajë: (shuma, numri dhe frekuenca e pagesave që do të kryhen nga konsumatori - me një shembull të personalizuar) <u>Interesi dhe/ose komisionet do të paguhet në mënyrën e mëposhtme:</u></i>
Shuma totale që konsumatori do të ketë për të paguar. <i>(Nënkupton shumën e fondeve të mundshme për t'u marrë hua, plus interesat dhe kostot e mundshme që lidhen me kredinë)</i>	<i>(Shuma e totalit të kredisë dhe totalit të kostos së kredisë)</i>
Nëse është e aplikueshme Garanci/siguri të nevojshme. <i>(Përshkrimi i garancisë që do të ofrohet në lidhje me kontratën e kredisë)</i>	<i>Lloje të garancive</i>

3. Kostoja e kredisë

<p>Norma e interesit të kredisë që do të aplikohet në kontratën e kredisë.</p>	<p>[-Normë fikse e interesit për kredinë në %, ose - normë e ndryshueshme e interesit për kredinë në % (e cila llogaritet mbi bazën e një indeksi orientues apo normës referencë), -periudhat]</p>
<p>Norma efektive e interesit (NEI) Është totali i kostos së kredisë për klientin, e shprehur si përqindje vjetore e vlerës së kredisë së dhënë dhe e llogaritur në përputhje me rregulloren për normën efektive të interesit dhe kërkesat për shpalesje, të publikuar nga BQK.</p>	<p>[Në % një shembull përfaqësues që përmend supozimet e përdorura për llogaritjen e normës që do të përcaktohen këtu.]</p>
<p>A është e mundur të përfitohet kredia sipas kushteve në të cilat tregtohet, duke përjashtuar: -kontratat e sigurimit për kredinë -kontratat tjera ndihmëse ? Nëse kostot e këtyre shërbimeve nuk njihen nga kredidhënësi, ato nuk do të përfshihen në NEI.</p>	<p>Po/jo [nëse po, specifikoni llojin e sigurimit]</p>
<p>Kosto të tjera të lidhura me kredinë.</p>	
<p><i>Nëse është e aplikueshme</i> Mbajtja e një ose më shumë llogarive është e kërkuar për të regjistruar si transaksionet e pagesave ashtu edhe tërheqjet apo transferimet e fondeve nga njëra llogari në tjetrën.</p>	
<p><i>Nëse është e aplikueshme</i> Çdo kosto shtesë që është e detyrueshme për përfitimin e kredisë.</p>	
<p><i>Nëse është e aplikueshme</i> Shuma e kostove për përdorim të caktuar të një pagese (p.sh. një kartë krediti).</p>	
<p><i>Nëse është e aplikueshme</i> Ndonjë kosto tjetër që rrjedh nga kontrata e kredisë.</p>	
<p><i>Nëse është e aplikueshme</i> Kushtet, sipas të cilave kostot e lartpërmendura që kanë të bëjnë me kontratën e kredisë mund të ndryshojnë.</p>	

<p><i>Nëse është e aplikueshme</i></p> <p>Detyrimi për të paguar shpenzimet noteriale.</p>	
<p>Kostot në rastin e pagesave me vonesë.</p> <p><i>Mungesa e pagesave të kësteve mund të sjellë pasoja të rënda për konsumatorin dhe e bëjnë procesin e mbajtjes së kredisë më të vështirë.</i></p>	<p><i>Konsumatori do të ngarkohet me [... (normën e interesit të aplikuar dhe detyrime shtesë që lidhen me rastin e mospagesës në kohë të kredisë)].</i></p>

4. Aspekte të tjera të rëndësishme ligjore

<p>E drejta për t'u tërhequr.</p> <p><i>Konsumatori ka të drejtë për t'u tërhequr nga kontrata e kredisë brenda një periudhe kohore prej 14 ditësh kalendarike.</i></p>	<p><i>Po/Jo</i></p>
<p>Shlyerja (pagesa) e kredisë para afatit të maturimit.</p> <p><i>Konsumatori ka të drejtë të kryejë në çdo kohë, para afatit të maturimit, shlyerjen e pjesshme ose të plotë të kredisë.</i></p>	
<p><i>Nëse është e aplikueshme</i></p> <p>Kredidhënsi ka të drejtën e kompenzimit, në rastin e shlyerjes së kredisë para afatit të maturimit.</p>	<p><i>[Përcaktimi i kompenzimit sipas legjislacionit në fuqi]</i></p>
<p>Informimi në rast refuzimi të kredisë.</p> <p><i>Kredidhënësi duhet të informojë konsumatorin, menjëherë dhe pa komisione, nëse një aplikim për kredi është refuzuar, duke i vënë në dispozicion arsyet mbi të cilat është bazuar ky refuzim. Kjo nuk aplikohet nëse dispozitat e këtij informacioni janë të ndaluara nga ligjet e Republikës së Kosovës.</i></p>	
<p>E drejta për para-kontratë</p> <p><i>Ju keni të drejtë të kërkonit kopjen e para-kontratës për produktin kreditor dhe kredidhënësit duhet të ofrojë këtë para-kontratë pa pagesë. Kjo nuk aplikohet në rast se kredidhënësi vendosë të mos procedojë më tutje me lëshimin e kredisë për juve.</i></p>	

Skema e brendshme e ankimimit të konsumatorit kundrejt kredithënësit.	<i>Departamenti/njësia respektive (adresa dhe numri i telefonit) ku do të drejtohen rastet e ankimimit</i>
Periudha kohore gjatë së cilës kredithënësi ka detyrime që rrjedhin nga informacioni parakontraktor.	<i>Ky informacion është i vlefshëm prej datës.../.../... deri në datën .../.../...</i>

5. Informata shtesë në rastet e reklamimit në distancë të shërbimeve financiare

(a) lidhur me kredithënësin	
<i>Nëse aplikohet</i> Përfaqësuesi i Kredithënësit në Vendlindin ku banoni	<i>[Emri i kredithënësit]</i>
Adresa	<i>[Adresa e kredithënësit për t'u përdorur nga konsumatori]</i>
Numri i Telefonit (*)	
Adresa e postës elektronike (*)	
Numri i faksit (*)	
Adresa e web-it	
<i>Nëse aplikohet</i> Regjistrimi	<i>[Regjistri tregtar ku kredithënësi është regjistruar dhe numri i regjistrimit apo ndonjë ekuivalent me të cilin identifikohet në atë regjistër]</i>
<i>Nëse aplikohet</i> Autoriteti Mbikëqyrës	
(b) lidhur me marrëveshjen e kredisë	
<i>Nëse aplikohet</i> Ushtrimi i të drejtës së tërheqjes	<i>[Udhëzime praktike për ushtrimin e të drejtës së tërheqjes duke treguar, inter alia, (mes tjerash) periudhën e ushtrimit të kësaj të drejte, adresën në të cilën njoftimi për ushtrimin e të drejtës së tërheqjes do të dërgohet dhe pasojat për mosushtrimin e kësaj të drejte].</i>
<i>Nëse aplikohet</i>	

Ligji të cilin e ka aplikuar kredimarrësi si bazë për themelimin e marrëdhënies, para arritjes së kontratës së kredisë.	
<i>Nëse aplikohet</i> Dispozitën që specifikon ligjin që aplikohet për marrëveshjen e kredisë dhe/ose gjykatën kompetente	[dispozita relevante do të vendoset këtu]
<i>Nëse aplikohet</i> Gjuha e përdorur	Informacionet dhe kushtet e kontratës do të paraqiten në (gjuhën). Me pëlqimin tuaj, do të komunikojmë në (gjuhën/gjuhët) përgjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes së kredisë.
(c) mekanizmat e shqyrtimit jashtëgjyqësor	
Ekzistimin dhe qasja në mekanizmat jashtëgjyqësor	[nëse ekziston mekanizmi jashtëgjyqësor për shqyrtimin e kërkesës së konsumatorit dhe mënyra e qasjes në të]
* këto informacione nuk janë të detyrueshme për kredidhënësin	

Konsumatori
(Konfirmon marrjen e informatave mbi kredinë konsumuese)

(Emër Mbiemër, Nënshkrimi)

SHTOJCA 2

FLETA E INFORMATAVE PËR GARANTUESIN

Është kërkuar nga ju të jeni garantues?

Ju lutem lexoni me kujdes informatat në vijim!

1. Rreziqet

- Si garantues, ju merrni një rrezik serioz për t'u bërë përgjegjës për borxhet e dikujt tjetër.
- Nëse huamarrësi nuk mund të paguajë (ose nuk e paguan) borxhin për të cilin jeni pajtuar të jeni garantues, ju do të jeni përgjegjës për pagimin e borxhit.
- Garantuesi nuk është thjesht garantues vetëm për të nënshkruar një letër, një garantues premton të paguajë borxhet e papaguara. Në qoftë se huamarrësi dështon, huadhënësi ka të drejtë të kërkojë pagesën e borxhit nga garantuesi - huadhënësi nuk duhet të parashtojë padi ose të përpiqet të mbledhë borxhin nga huamarrësi para se të kërkojë këtë edhe nga garantuesi. Në vend të kësaj, huadhënësi mund (dhe do) të kërkojë nga ju që të paguani borxhin.
- Si garantues, ju do të klasifikoheni në regjistrin e kredive në bazë të kredisë për të cilën keni garantuar dhe kjo mund të ju kufizojë në marrjen e kredisë tuaj.

2. Vëmendjet

- Mos garantoni, nëse nuk mund të përballoni pagesën e borxhit dhe / ose pagimi i borxhit do t'ju shkaktojë probleme serioze financiare.
- Mendoni se borxhin e kujt do ta garantoni dhe përse është kërkuar nga ju të jeni garantues (nëse personi që kërkon nga ju të jeni garantues është i besueshëm, a mundet ai realisht të përballojë marrjen e kredisë, nëse kredia e kërkuar është e përshtatshme për këtë person, nëse arsyeja e marrjes së kredisë është e arsyeshme).
- Çka do të ndodhë nëse kërkohet nga ju të paguani borxhin? A do të ndikojë kjo në gjendjen tuaj financiare? Deri në çfarë mase? A do të ndikoheshin aspektet tjera të jetës tuaj?

3. Parandalimi

Nëse vendosni të jeni garantues, provoni të zvogëloni rreziqet:

- Kufizoni përgjegjësinë tuaj – ju nuk duhet të garantoni për të gjithë borxhet e huamarrësit, përcaktoni shumën e saktë për të cilën ju garantoni.
- Kërkoni dokumentacionin përkatës – ju duhet të dini detajet e kredisë për të cilën garantoni (pyetni për kontratën e kredisë dhe dokumentacionet përcjellëse), ju gjithashtu mund të kërkoni nga huamarrësi të ju informojë rreth gjendjes financiare të tij.
- Sigurohuni që të dyja palët si kreditori ashtu edhe huamarrësi të ju informojnë në kohë të duhur sa herë që interesat tuaja mund të preken.

Refuzimi për të qenë një garantues mund të vendosë marrëdhënien tuaj me huamarrësin në rrezik.

Megjithatë, pagesat për borxhet e dikujt tjetër mund të ju çojnë në vështirësi të mëdha!

Data: _____

Nënshkrimi: _____